Ishte nji vit e gjysë ma parë kur pata pa në bazament¹ eskpozitën e Genc Kadriut “Vela e dështimit të përherëshëm”. I kushtohej disa gjanave të vogla, të cilat, herë në vedi e herë të bashkueme, të shpërndame në atë hapësinë thuejse të kredhun nën tokë, si në nji kriptë, njallnin poetikisht tisin e trishtë të asaj përzgiedhjeje apo dekantimi. Në ekspozitën vetjake aktuale në GKK jam ndodhë kryesisht para pikturash. Autori e titullon atë *atelieri i piktorit të panjoftun*. Çka ka ndodhë? Në vështrim të parë, të duket se ka njifarë braktisje të qasjes së maparshme, por jo! Suporti asht njifarë telaçoje, por që rezulton jo vetëm aq. Pikënijsa duket se merr shkas prej ekspresionizmit abstrakt, porse gjesti nuk mjaftohet me lanë gjurmë në sipërfaqe të pëlhirës, por edhe merr sende sa andej-këndej dhe i përfshin mbrenda kuadratit të pikturuem. Piktura e tij kombinohet² me po ato gjana, që bajnë pjesë në repertorin që ka pasë dhe që e pasunon vazhdimisht, për të cilat, e me të cilat, ai dishron me përcjellë atë çka e prek. Janë sende të njimendta, landë të para e produkte: minerale, pigmenta natyrale, leskra suvaje afreskesh, gozhda të ndryshkuna, kuarc, pjesë eshtnash, fosile, guaska moluskësh, qymyr, pluhun pigmentesh (indigo prej Marokut), akrilik, rrshinë, dyll, qira, bimë, fryte, lule e barna të thata, dikur me lang e kundërmues, insekte (brumbuj), gjallesa (zvarranikë, hardhuca), të gjetuna të ngrime si në prag të daljes prej letargje, pendë zogjsh, të gjitha relike, pra hedhurina, mbetje. Përbasit bartin tiparet dhe veçoritë e landës, rrinë në pikture për atë çka janë, për ngarkesën emocionale të vendit nga ku vijnë, por edhe për domethaniet apo referencat që zgjojnë. Ato, herë i janë gjendë para syve, e herë ka shkue me i kërkue ndër vende të ndryshme, duke i mbledhë si kampione prej trashëgimisë gjeologjike, asaj të florës e faunës dhe prej trashëgimisë shpirtnore (citim i autorit).

Itinerari i tij ka ngjitje e zbritje, ngjitet nga deti te qielli e zbrejt në tokë. Shkon në minierën që ngjan si humbellë e nji bote të tmerrshme, me marrë qymyrin, ashtu siç ka shkue me marrë nji dredhëz prej vendit ku ka ndodhë nji masakër, duke prue atë çka mban nëntoka e atë që ushqen ajo. Prandaj, ndryshtë prej *merzbau*-t të dadaistit Kurt Schwitters, këto nuk janë të gjetuна rastësisht, por të kërkume e të ruejtuna. Ky cikël i mboramë asht realizue para disa muejsh, por gjanat janë mbledhë ndër vite. Ato kanë zgjue vëmendjen e tij, e kanë shenjue, kanë xanë nji kohë në ekzistencën e tij dhe tesh vijnë bash si dëshmí të shkapërdame përjetimesh. Gjesti i tij nuk asht ai i koleksionistit të apasionuem, por ka njetin e shtegtarit të përshtiprtshëm mesjetar, që sillte dikur prej vendeve të shejta relike të çmueshme, nji grimcë muri, dheu, nji petk a nji copë të tij, nji vel, nji gozhë, nji kunorë a vetëm nji eshtën shjetit. E ajo grimcë a pjesëz nënkupton nji lloj sinekdoke, jo të fjalëve, por të sendeve, atë që e bartin posaçërisht

reliket, duke sjellë sot veç nji pjesëz, në vend të së tanës, që ka humbë përfundimisht. Nji sosh vendosej në qendër

¹ Hapsinë ekspozuese e fondacionit me të njëtin emën në Tiranë për artistë premtues.

² Si combine-painting e Rauschenberg

të ngrehinës fetare e bartte peshën de-vocionale e shpirtnore, si guri i qoshes atë materiale. Veprimet e artistit i përafrohen edhe nji procesi të kahershëm alkamik, i cili mshehë mjaft simbolizëm të errët, duke kalue nëpër fazat të ndryshme, për të krijue të çmueshmen. Njashtu si dikur te dadaistët, mqedisi nuk ka në vetëvedi ndonji

cilësí estetike, por gjithsekush mund t'i hetojë e interpretojë lirisht, pra estetikisht, elementet që e përbajnë, duke i devijue prej qëllimit utilitar që i jep atyne nji shoqni utilitare. Veprimtaria posaçërisht estetike nuk priret me modifikue kushtet objektive të ekzistencës, por me dhanë modelin e nji sjelljet të lirueme prej çdo kushtëzimi. Pikërisht për këtë, ai befason duke krijue sinestezí me ndërhyrje e taktika përbashkuese, që lypin nji larmi të paparagjykimtë qëndrimesh e mjetesh teknike. Pëlhura e mbërthyeme në nji telajo nuk asht rrafshi i projektimit të tyne, as thjesht nji hapsinë imagjinare e zbrazët dhe vetëm e disponueshme, ajo asht nji prej elementeve. Duket ma shumë si nji fushë magnetike, që tërheq e ngërthen. Gjestet piktorike, prekjet e tij në sipërfaqe, i përshtat me ato gjana që përfshin në lojën e kuadrit. Ka rastisë që nuk e ka zgiedhë kanavacën e linit, por pëlhirën e çarçafit: çarçafat e familjes, ndër elementet ma privat e ma intim, aty ku janë prehë për s'gjalli e s'dekuni t'afërmët e tij. Ato janë kenë përdorë edhe për me mbledhë ullinjtë e manat. Ai asht suporti me ngarkesën e vet funksionale e simbolike, por që ofron edhe mundësinë me kënaqë magjepsjen e tij ndaj mënyrave primordiale të pikturimit me duer e në sipërfaqe të mëdha. Përmasat e pikturave thuejse ruejnë përmasat e tyne. E njashtu si janë çarçafat (tek e dopio), ato shfaqen si diptikë e triptikë. Mënyra e aplikimit të bojnavë nuk asht ngushtësisht ajo e piktorit. Ato stërpiken, derdhen e mbasandej, ndërhyhet me brushë e spatul. E para, si nji fshesë, mbledh të tepërtën prej pëlhirës, ndërsa e dyta (sheja e saj mbetë në negativ si dëshmi), heq atë çka asht fshí. Të derdhuna si pluhun mbi pëlhirë, ngjyrat poashtu veprojnë si nji landë që pret e u ban vend gjanave.

Kornizimet e boshit, që dalin aty-këtu, evokojnë ndjesinë e zbratzisë, që mbetet kur hiqen fotografi e pikura prej murit, si praní e mungesës.

Orvatja e tij për me pikturue çarçafin-sfond të relikeve asht nji dëshirim që, të paktën në fiksionin e nji suporti, i cili merr ngjyrat e stinëve, të ndodhë diçka që, në mjeshtësi e galerisë a muzeut, përndryshe mund të mos ndodhë. Të përfshime aty, si në qendrën e nji gjerdeku, disa pësojnë nji soj tjetërsimi (qírini i dyllit në çarçafin-pranverë ngjallët duke u shndërrue në nji gjarpën të vogël).

Asgja nuk i asht lanë mureve të galerisë, mbrenda sipërfaqes të secilës prej telajove gjemjë të futuna, si te legjendat te hartat, vargje-tituj edhe listat e përbásave. Fjalët e sendet, vargjet dhe përbásat, prej domethanies e kadencave të tyne, çlirojnë flurime prekëse e mistike. Objektet e pajetë cojnë nji jetë misterioze përtëj të kuptuemit tonë, dhe kjo asht pjesërisht arsyaja pse ato janë aq intriguese për poetët. Ajo çka shohim na shfaqet si nji përgatitje formulash ezoterike, që fut në vendin e duhun disa grimca landore, bashkë me përshkrimin e tyne, dhe disa fragmente poezish, shkurt, nji recetë e kombinume landësh e fjalësh, ofrue prej artistit-mikologjist. Ky repertor objektesh e fragmentesh minore, njikohësish të parandësishme e të dashtuna, duket se, përvçe të pamit, ndjell edhe shqisat e tjera, si nuhatjen

dhe prekjen. Veprën e shfaqun e quen *atelier* e jo *ekspozitë*, duke i mshue procesit e jo përfundimit. Krejt çka shfaqet difton nji proces që i ngjan nji liturgjie okulte shndrruese, e cila ndjell shpresa të nakatosuna dhe fuqi të mbropshta e të namatisuna të hukasin

mbi to. Autori qysh në krye të herës na ban me dije se kush asht muza e tij, duke u prì të shndërrrohet në nji *signum contradictionis*. Ndër bimët aromatike asht edhe nji që quhet *makth*,³ ... e t'kndlëllë.

Ndoshta atë e mundojnë kontradiktat e ekzistencës së vet në shoqinë aktuale, në të cilën këto lloj preokupimesh ende nuk marrin ndonji peshë të madhe, nji shoqni që nuk ka mëshirë për të kaluemen, e njeh veç të sotmen. Ai nuk asht i përfshimë bëndshëm në jetën konkrete materiale. Ndoshta duke u ndí i përjashtuem prej kësaj të tashme, ai ripërdor mbetjet sikur po shpëton vedin prej rrëthanës historike të hedhurinës. Të gjithë ato sendërtime inerte kujtimesh janë konteksti ekzistencial i artistit, kështu që ai nuk ndalet t'i objektivizojë. Simbas referencave të tij, arti asht hymja në kaos, në të pashquamen. Ai tretet e identifikohet me atë përzimje gjanash që janë të tijat, ashtu siç ishin regjistrimet e tij fotografike të ritit mortor familjar të do vjetve ma parë. Kjo i jep lirizmit të veprës së tij edhe nji ndjesi tragizmi.

Çarçafët e shtrimë ratë, mbi të cilët ka punue e ka rendue horizontalisht sendet e mbledhuna, i çon dhe i ekspozon vertikalish. Kështu, objekteve i ndrron pika e pamjes prej nelt-poshtë, duke humbë perspektivën si në pikturat egjiptiane. Duke i que në kambë, ngjan se ato nisin lundrimin e vshtirë nëpër kohën bluese, megjithë brishtësinë e tyne (pigmentet nuk janë të fiksueme). Atëherë, nga shtroje, ato kthehen në vela (e nuk janë ma gjethet e larit), që marrin në lundrim gjanat e tij, duke shpërfaqë rrjedhën e kohës nëpërmjet dritëhijeve dhe temperaturave të stinëve. Kulti i relikeve shkon krah për krah me doktrinën e ringjalljes, e cila pohon se korpia ka me u ringjallë në fund të kohëve. Autori endet me objektet e zgiedhun mbi këto çarçafa-vela të shpalosun në të tanë pasigurinë e tyne, e të vetën. Ato e kanë pasë përpara nji jetë, e ai rreket me u dhanë nji tjetër.

It was a year and a half ago when I saw Genc Kadriu's exhibition, "The Sail of Permanent Defeat," at bazaar¹ art space. It was dedicated to some small objects which, spread out in that cryptic space immersed underground, would poetically evoke the sad veil of that selection, or decantation. In the solo exhibition at the National Gallery of Kosovo, I found myself mainly in front of paintings. The author titles it "The Atelier of the Unknown Painter." What has happened? At first glance, it appears as if there's been an abandonment of the previous approach—but no! The support is a kind of canvas, but which results in more than that. The starting point seems to spring from abstract expressionism, except that the gesture is not content with only leaving traces on the surface fabric, but also puts things in, here and there, incorporating them within the painted frame. His painting is combined² with the same things that are part of a repertoire that he has had in the past and continuously enriches, for which and with which he wants to express what moves him. These are real things, raw materials and products: minerals, natural pigments, shreds of fresco plaster, rusted nails, quartz, pieces of bones, fossils, mollusc shells, coal, pigment powder (indigo from Morocco), acrylic, resin, wax, candles, plants, fruits, flowers and dried herbs, once moist and pungent, various creatures— insects (beetles) and reptiles (lizards)—found frozen as though on the verge of coming out hibernation, bird feathers, all relics, refuse, debris. The ingredients carry the characteristics and traits of their matter, they rest on the painting for what they are, for the emotional charge of their origins, but also for the meanings and references they awaken. At times they appeared before his eyes, and at other times he went looking for them in different places, collecting them as samples of geological heritage, of flora and fauna, and of spiritual heritage (the artist's phrasing). His itinerary has ascents and descents: climbs from the sea to the sky and descends back to the ground. He travels to the mine, which resembles the abyss of a terrifying world, to collect the coal, just as he went to pick a strawberry from the site of a massacre, bringing to light what the underworld bears and what it nourishes.

That is why, different from the *Merzbau* of the dadaist Kurt Schwitters, these are not randomly found objects, but sought after and preserved. This last cycle was realized months ago, but the objects have been collected throughout the years. They have attracted his attention, marked it, took a slot of time in his existence, and now emerge as scattered testimonies of experience. His gesture is not that of the impassioned collectionist, but has the drive of the devoted medieval wandering pilgrim, who would once bring from the sacred lands

precious relics, a scrap of a wall, of earth, a garment or a piece of it, a veil, a nail, a crown, or only a bone of a saint. And, that particle or part connotes a kind of synecdoche, not of words, but of things, that which relics evoke by bringing only a part instead of the whole that has been forever lost. Such a relic would be placed at the center of a religious edifice and would carry the devotional and spiritual burden, just like a cornerstone carries the material

1

An exhibition space for promising artists in Tirana.

2

Like the *combine* paintings of Robert Rauschenberg.

one. Here, the actions of the artist come close to an old alchemical process which, going through different stages, conceals a lot of dark symbolism so it can produce the precious. As with the dadaists before, the environment does not have an aesthetic quality in itself. Rather, anyone can freely investigate and interpret by themselves, aesthetically, the elements which compose it by removing them from the utilitarian purpose granted to them by a utilitarian society. Aesthetic activity does not tend to alter the objective conditions of existence, but to propose a response model free from any conditioning. Precisely because of this, the artist surprises by creating synaesthetic effect through combinatory tactics which require a variety of unbiased range of stances and technical tools. The canvas fabric is not the surface of their projections, nor merely an empty space available to the imagination; it is one of the elements, among many. It appears more like a magnetic field that attracts and ensnares. Pictorial gestures, his touches upon the surface, are adapted to the things which are included in the play within the frame.

It happened that he did not choose a linen canvas, but bedsheets. Family bedsheets, one of the most private and intimate of elements, where his kin has rested in life and in death. It is a painting's support with a functional and symbolic charge, but it also gives him the opportunity to enjoy his enchantment with the primordial way of painting using bare hands, and on large surfaces, too. The dimensions of the paintings almost preserve the original size of the sheets. And just like the beddings (single and double), so are the paintings displayed as diptychs and triptychs. The method of paint application is not strictly that of a painter. He sprinkles and pours on them, and then intervenes with brush and spatula. The first, like a broom, sweeping off the excess, the second (its trace remains like testament in negative) carrying away the remnants of that which has been removed.

The colors do not shimmer; spilled like dust over the fabric, they act like a material that cuts through and makes room for objects.

The framings of void that emerge here and there evoke the feeling of emptiness left once pictures are removed from a soot laced wall, like a presence of absence.

His efforts to paint the bed sheet-background of the relics is an inclination, at least within the fiction of a support that takes the colors of seasons, for something to happen in the environment of the gallery or the museum, which otherwise could not have occurred. Included there, as if in the center of the matrimonial chamber, the materials experience a metamorphosis (the votive candle on the spring bedsheets is animated by transforming into a small serpent).

Nothing has been left for the gallery walls; within the surface of each canvas we find verse-titles and ingredient lists, inserted like map legends. Words and things, verses and ingredients, from their meaning and cadences, unleash moving and mystical flights.

Inanimate objects lead a mysterious life beyond our understanding and that is partly why they are so intriguing to poets. What we see is presented to us as a concoction of esoteric formulas that put a few grains of matter, their description and some poetry frag-

ments in the right order. A combined recipe of words and materials given to us by the artist-mixologist. This repertoire of objects and minor fragments seems to trigger other senses apart from sight, such as smell and touch. The presented work is called an 'atelier' and not an 'exhibition', targeting thus the process rather than the result. All that is shown to us tells of a process resembling a transformative liturgy of the occult, which rouses beaten hopes and wicked hums that blow out spells. From the outset, the author makes it known to us who his muse is, inclined to be turned into a *signum contradictionis*. Amongst the botany of aromatic plants there exists one that's called *nightmare*³... yet it revitalizes you.

Perhaps he is tormented by the contradictions of his own existence within current conventions, in which these kinds of preoccupations still do not impart adequate significance, a society that undeniably has no mercy for the past, it acknowledges only the present. He is not convincingly involved in the reductionist materialistic life. Perhaps feeling prevented from this present, he reuses its remains in a desperate attempt to save him from the historical condition of the expendable. All these fixed re-constructions of memories are the existential context of the artist, so he persists exteriorizing them. According to his allusions, art is the entry into chaos, into the indiscernible. He merges and identifies with this compounding of things that are his, like some years ago for instance with the photographic images of his family's funeral rite. This gives a sense of tragedy to the lyricism of his work.

The bedsheets laid flat, on which he worked and arranged horizontally the gathered objects, he lifts and exhibits vertically. As such, the point of view of objects changes from above-below, losing the perspective like in the paintings of Ancient Egypt. Raising them up they seem to begin the difficult glide through the grinding time, with all their precariousness (the pigments aren't fixed). Thus, from flat layers, they become sails (no longer laurel leaves) which carry his objects along the stream of time, throughout light-and-shades and temperatures of seasons. The cult of relics goes hand in hand with the doctrine of reincarnation, which claims that the Body shall be reborn at the end of Time. The author wanders over these bedsheets-sails with his chosen objects and all their unfurled uncertainty, and his own. They had a life once before, he seeks to give them another.

3
Helichrysum italicum.



NË ÇARÇAFË TË BARDHË

Ervjola Selenica

Bluja kapërcen gjeografinë solemne të kufijve njerëzor.
—Derek Jarman

Bluja është e padukshmja që bëhet e dukshme.
—Yves Klein

MATERIA

Sa mund të përbajë një çarçaf? Çfarë mund të mbajë dhe qfarë do të lëshojë? Çfarë fsheh dhe qfarë do të zbulojë? Çarçafët e bardhë — një obesion i imi prej kohësh. I kam mbledhur në mënyrë kompulsive ndër vite. Çarçafë të bardhë të pistë dhe me njolla, të errëta si dëshira e njeriut. Me fije liri dhe kërpri. Me material të papërpunuar dhe tejet real. Nga ai lloj që të fërkon lëkurën dhe të lë gjurmë. Nga ato të padukshmet. Fije të trasha të bardha të vjetra, që përthithin ngjyrën, djersën dhe aromën më saktësi, dhe me më shumë lirshmëri. Si mund të shkruajmë mbi të pavetëdijshmen? A mund të arrijmë atë që e kemi shtypur individualisht dhe kolektivisht? Njeriu mund të vështrojë të pavetëdijshmen vetëm nga këndi i preferuar i lojës, pra, èndrrat. Apo ndoshta dikush, përveç èndrrave dhe psikanalizës, arrin të zhytet në vertikalitetin e pavetëdijshmen? Kjo mund të arrihet, ndoshta, përmes spekulimeve poetike, èndrrave vetjake, dhe të tjerëve – shkrimitarë, artistë dhe piktorë — në dialog me praktikën dhe procesin e krijimit të artistit.

Si mund të shkruajmë mbi një eksposítë, prapavija dhe ambicia e qartë e së cilës është një “kaligrafi e të pavetëdijshmes”? Kjo mund të arrihet, ndoshta, përmes spekulimeve poetike, èndrrave vetjake, dhe të tjerëve – shkrimitarë, artistë dhe piktorë — në dialog me praktikën dhe procesin e krijimit të artistit.

NGJYRA

Kur Derek Jarman-it filloi t'i venitej shikimi, shkreptima të blusë së ndezur si ato të Yves Klein-it ishin të fundit që mbijetuan. Ashtu duket pluhuri i ngjyrës indigo tashmë të balsamuar në dy pikturat e Kadriut me titull, “Në mes të eksitimit dhe qetësisë ... trëndafil blu i vëtmuar”. Në filmin e fundit të Jarman “Blue” thuret një tapet ndjesor që shërben si meditim mbi Erosin dhe Thanatosin, sëmundjen, dashurinë dëshirën. Ta bënte sublime blunë ishte një nga ambicjet e tij. Bluja, e cila për nga pastërtia dhe dinjiteti ontologjik, është superiore ndaj kaosit të materies. A është bluja një derë e hapur për shpirtin? Për turbullirën e tij të pastër? Në eksposítën e Kadriut, bluja hyn në fushë si kumtim, rrjedh nga e bardha e papërlyer, shpërthen nga tekstualiteti i çarçafit dhe mbetet aty, e hapur, herë si plagë, e herë si syth. E padepërtueshme. E maturuar me premtimet si trëndafil. Si sytha që shënojnë ikjen e dimrit në pranverë. Ose si fole. Ka disa fole të tillë brenda pikturave. Brenda, sepse ka një thellësi shumështresore në materialitetin e këtyre pikturave. Mund të gërmoni dhe të zhyteni. Kuptimi do t'ju ikë. Ose do të luaj me ju.

E pavetëdijshma është e strukturuar si gjuhë, siç thoshte Jacques Lacan. Një gjuhë dëshirash, të paplotësuara. Dhe traumash. Po ngjyrat që janë përdorur? Këto ngjyra digjen, murmurisin dhe dridhen. Temat ekzistenciale dhe eksperimentimi mbivendosen nga goditjet akute, të mprehta dhe impulsive të penelit, dhe nga gjervishtjet që pikojnë në njëra-tjetrën.

¹ Cituar në Trine Otte Bak Nielsen et al., *Omega's eyes: Marlene Dumas on Edvard Munch* (Oslo, Norway: Munch Museum, 2018). Përkthimi i autores.

PULSIONI I PREKJES

Brenda pikturës reprezentative, piktori norvegjez Edward Munch zhvilloi një ndjesi radikale të materialitetit: "Ai gërrici e gërvishtri sipërfaqet e tij, lejoi pikime dhe spërkatje të dukshme, i nënshtroi pikturat e tij ndaj motit, dhe brenda një kompozimi të vetëm përfshiu sipërfaqe të holla dhe të trasha"². Në proces e sipër, veprat e Kadriut përcjellin një vizualitet të shtrirë dhe transhendent, si dhe thellësisht të mishëruar dhe të papërsosur. Sa të mishëruar? Sikur i gjithë trupi, e gjithë lëkura, t'i dorëzohej teksturës së ngjyrave, fibrave dhe dritës. "Individu shpërbëhet ose zgjidhet në absolut; por absolutja nga ana e saj, është gjithmonë individuale. Ky është misteri i çdo besimi, i çdo arti [...]"³.

DRITA

Në procesin e bërges, krijimit dhe zhbërges, fshirjes dhe ngulitjes, një yjësi gjurmësh, shenjash, fjalësh, objektesh të mbledhura e të gjetura, ngrihen bashkë në dinjitetin e Gjësë. Gjëja e paemër. Si një spirale që kalon përmes materialitetit të teksturës, ngjyrës dhe dritës, ashtu lëviz pulsioni prekës i shënjimit, furçës dhe ferkimit. Lëviz rrötull pa arritur kurrë Gjënë e humbur. Por, zhytet thellë brenda asaj që ne nuk mund ta kapim. Kjo lëvizje duket sikur luhatet mes qenies dhe mosqenies. Dhe rri pezull në hendekun e kriuar mes të dyjave. Gjurmët e asaj çfarë mungon, dhe pesha e tyre, janë të dukshme. E pranishmja është e dukshme. Të dyja janë njëkohësisht të lirshme dhe precise. Veprat nxjerrin një fund të hapur që nuk është punë e papërfunduar. Poetikë e një gjeti që ndalon aty ku duhet të ndaloj, në formë të papritur dhe të paparashikueshme. Kjo u jep pikturave një hapje që luhatet midis brishtësisë dhe forcës. Ka kaq shumë hapësira të papërpunuara që marrin frymë nga drita. "Kush e zoteron dritën?", pyet Kadriu. "Drita është misteri suprem [...] sistemi ynë nervor i përkthen forcat e errëta dhe të verbëra të universit në dritë (në çdo ndjesi ka diçka shndritëse), e fshehur përgjithmonë nga të kuptuarit tonë, e fshehur pikërisht nga drita", shkruan Andrea Emo në fletoret e tij sekrete.⁴

PËRKOHËSIA

"E panjohura kohë", shkruhet në një nga pikturat. Është një lloj kohshmërie "e karakterizuar nga ndjesi të shumta, shpesh kontradiktore, të kohës që ekziston në tension midis të kaluarës dhe së ardhmes ekspansive dhe transhendente, dhe të tashmes akute dhe urgjente".⁵ Një poetikë që të lejon lëvizjen brenda dhe përreth, rrötullimin në spirale, përmes dhe drejt një ritmi zgjerues dhe gjenerues të mishërimit. Koha e tashme — si qenie dhe si mosqenie. Si ngulitet dhe regjistrohet koha në vepra, në fragmentet dhe tërësinë e çdo pikturë? Cila kohë dhe koha e kujt?

PAVETËDIJA

Veprat kanë një si têrheqje magnetike që të largojnë dhe të shtyjnë më pranë telajove. Têrhiqesh nga çdo fragment, pjesëza të një yjësie fragmentesh brenda veprës, që shkojnë përtëj kornizës, një vepër pa kufi dhe pa fund. Çdo njollë, objekt, furçë, është një nga portat e shumta të hyrjes në mënyrë johierarkike. Hyrje në një formë të ngatërruar të gjërave dhe marrëdhënieve, të dukshme dhe të padukshme, siç do të thoshte Timothy Morton. Kjo decentralizon dhe fragmenton artistin, si vetveten në ëndrra. Ndodh shtytja për të zhvendosur

veten në vepra dhe për të tejkaluar veten përmes të njëjtave vepra. Një hendek krijohet këtu. Një puls. Dhe e gjitha pikon, si në ëndrrën time të 6 majit, 2022. Po ëndërroja pika gjigante uji fillimisht; më pas, pikat u shndërruan në yje që binin; yje që binin si kometa dhe vërshenin gjithë qiellin, shpérthenin, digjeshin, si gërvishje të zjarrta. Pikërisht si kur dikush ndjen nga afër drithërimën e Reales. Nga ajo që kthehet në jouissance dhe të shtyn edhe më shumë buzë çmendurisë. Tek e pakufshimja spirale, joshëse dhe e tmerrshme e Reales. Duke qenë se Realja nuk mund të shkruhet, ajo as nuk mund të pikturohet. Sidoqoftë, mund të shkruash dhe të pikturosh në mënyrë të tillë që të fërkohesh pas saj. Ku fillon *cetonia aurata* dhe ku përfundon trëndafili?

2

Richard Shiff in Gary Garrels, Jon-Ove Steihaug, Sheena Wagstaff, ed., *Edvard Munch: Between the Clock and the Bed* (New York: Metropolitan Museum of Art, 2017). Përkthimi i autores.

3

Andrea Emo, *Quaderni di metafisica*, 1927-1981, ed. Massimo Donà and Romano Gasparotti (Milano, Italy: Bompiani, 2006). Përkthimi i autores.

4

Ibid.

5

Ellen Samuels, "Six Ways of Looking at Crip Time," *Disability Studies Quarterly* 37, no. 3 (August 31, 2017). Përkthimi i autores.

ON WHITE BEDSHEETS
Ervjola Selenica

Blue transcends the solemn geography of human limits.
—Derek Jarman

Blue is the invisible that becomes visible.
—Yves Klein

MATTER

How much can a bedsheet contain? What can it hold and what will it release? What does it conceal and what will it reveal? White bedsheets — a long-time obsession of mine. I've collected them compulsively through the years. Dirty white and stained bedsheets, opaque as human desire. Made of linen and hemp. Of raw materials and thoroughly concrete. The kind that rubs your skin and leaves traces. Invisible ones. Old white thick fibres, that absorb colour, sweat and scent with precision, and far more looseness. How can one write about the unconscious? Can one reach what is repressed individually and collectively? One can only gaze into the unconscious from its favourite playground, i.e., dreams. Or can one, besides dreams and psychoanalysis, dive into the verticality of the unconscious temporality through art? That is what the works of Genc Kadriu in "The Atelier of the Unknown Painter" seem to propound. Here, the bedsheets serve as a mirror of the excesses of the Real. To the latter's untamed drives and energies. "Painting is not speechless. It overflows. It is a drunken mermaid's song," says another painter, Marlene Dumas.¹ Words have this archaic and painterly quality in Kadriu's works. The titles are painterly, too. How can one write about an exhibition whose underpinning and explicit ambition is a "calligraphy of the unconscious"? One can arrive there, perhaps, through poetic speculation, dreams of one's own, and others' — writers, artists and painters in dialogue with his practice and process of creation.

COLOUR

When Derek Jarman's eyesight started to fade, flashes of bright blue, not unlike Yves Klein's blue, were the last to survive. So seems the indigo powder that is now embalmed in two of Kadriu's paintings, titled "Among excitement and repose grows a lonely spring's blue rose." Jarman's last film "Blue" weaves a sensory tapestry that serves as a meditation on Eros and Thanatos, illness, love and desire. To elevate the colour blue was one of his ambitions. Blue, which in terms of purity and its ontological dignity, is superior to the chaos of matter. Is blue an open door to the soul? To its pure opacity? In Kadriu's exhibition blue enters the field as an enunciation, it leaks from the immaculate white, erupting from the textuality of the bedsheet, and remains there, open as a wound, at times as a bud. Impenetrable. It is ripped with promises of a rose. Like the buds that mark the fading of winter into spring. Or a nest. There are several of such nests within these paintings. Within, because there is a multi-layered depth in their materiality. You can dig and dive, yet meaning will escape you. Or just

play with you. The unconscious is structured like a language, as Jacques Lacan's famous formula states. A language of unfulfilled wishes. And traumas. But what about the use of colours? These colours burn, stutter and quiver. Existential themes and experimentation overlap through the acute, sharp and impulsive strokes and scratches, bleeding into each other.

1

Cited in Trine Otte Bak Nielsen et al., *Omega's eyes: Marlene Dumas on Edvard Munch* (Oslo, Norway: Munch Museum, 2018).

THE TOUCH DRIVE

Within representational painting the Norwegian painter Edward Munch developed a radical sense of materiality. "He scraped and scratched his surfaces, allowed visible drips and splatters, subjected his canvases to weathering and incorporated thin and thick areas within a single composition."² And in the process, Kadriu's works convey a visuality that is expansive and transcendent, as well as deeply embodied and imperfect. How embodied? As if the whole body, the whole skin had been invested into the texture of colours, fibres and light. Every inch. "The individual dissolves or resolves into the absolute; but the absolute in turn, is always individual. This is the mystery of every faith, of every art, [...]"³

LIGHT

In the process of making, creating and unmaking, erasing and imprinting, a constellation of traces, signs, words, collected and found objects are raised together to the dignity of the Thing. The unnamed Thing. Like a spiral that goes through the materiality of texture, colour and light, and the touching drive of marking, brushing and rubbing.. It moves around without ever reaching the lost Thing. But it plunges deep within that which we cannot grasp. This motion seems to swing between being and non-being. It hovers in the gap created between the two. Traces of what is absent, and their weight, are visible. What is present can be seen. Both are simultaneously loose and precise. The works emanate a trembling lightness. This endows them with an openness that fluctuates between fragility and strength. There are so many raw interstices that breathe with light. "Who owns the light?" asks Kadriu. "Light is the supreme mystery [...] our nervous system translates dark and blind forces of the universe into light (in every sensation there is something luminous), hidden forever from our understanding, hidden precisely by the light," writes Andrea Emo in his secret notebooks.⁴

TEMPORALITY

"Unknowingly Time" is written in one of the paintings. It is a kind of temporality "characterised by multiple, often contradictory, sensations of time that exist in tension between the expansive and transcendent past and future, and the acute and urgent present."⁵ A poetics that allows you to move, in and around, spiralling within, through and towards an expansive and generative rhythm of embodiment. Present tense — as both being and non being. How is time imprinted and recorded in the works, in the fragments and totality of each painting? Which time and whose time?

THE UNCONSCIOUS

The works pull and push you farther and closer to the canvases. You are drawn to each fragment, part of a constellation of fragments of a broader work that transcends the single frames, a work without limit and end. Each drop, object, brushstroke provides multiple points of access in a non-hierarchical way. One enters in an entangled way, of things and relations, visible and invisible, as the philosopher, Timothy Morton, would say. It decenters and fragments the artist, as oneself in dreams. An urge occurs, to transfer oneself in the works and to transcend oneself through the same works. A gap

is created therein. A pulse. And it all drips, like in that one dream I had on May 6, 2022. It was giant drops of water in the beginning; then, drops transmuted into shooting stars; shooting stars into comets, showering the whole sky, bursting, burning, like inflamed scratches. Exactly how one feels in the thrill of the Real. The one that becomes jouissance while also pushing you closer to the edge of madness. To the spiralling, tempting and terrifying borderlessness of the Real. As much as the Real cannot be written, it cannot be painted either. However, one can write and paint in such a way as to brush against it. Where does a *cetonia aurata* begin and where does a rose end?

2

Richard Shiff in
Gary Garrels,
Jon-Ove Steihaug,
Sheena Wagstaff,
ed., *Edvard Munch :
Between the Clock
and the Bed* (New
York: Metropolitan
Museum of Art,
2017).

3


Andrea Emo,
*Quaderni di
metafisica*, 1927-
1981, ed. Massimo
Donà and Romano
Gasparotti (Milano,
Italy: Bompiani,
2006).

4

Ibid.

5

Ellen Samuels, "Six
Ways of Looking
at Crip Time,"
Disability Studies
Quarterly 37, no. 3
(August 31, 2017).
Përkthimi i autores.



Thuhet *art i mosnjohjes* sepse përmasa enciklopedike, gnoseologjike dhe hermeneutike e artit janë përjashtuar për t'i lënë vend ngjarjes së kulluar të ndjimit estetik. Artisti i panjohur është gjimnasti i *mosnjohjes*, sepse të vetmen mjeshtëri që ushtron është ajo e provokimit të sinestezisë, fuqisë së kulluar të të ndjerit.

Distanca mes dijes dhe mosdijes së artistit nuk është epistemike por estetike, prandaj sondimi i kësaj hapësire ideale kërkon ngjizjen e një imazhi të ri mendimi. Arti si pragmatizëm i *mosnjohjes* është ushtrim i ca kritereve si shtrëngesa estetike radikale. Kërkohet që artisti të vijë nga larg, nga një hapësirë kritike e ekzistencës së saturuar në shenja që s'rrëfejnë më asgjë.

Mosnjohja shërben për të zbuar dijen dhe dijetarët, padjen dhe opinionistët. E panjohura te artisti ynë ka të bëjë me pamundësinë e tij ideale pér të reshtur së mësuari. Dhe është i yni sepse vetëm artisti që s'di pér ne, mund të arrijë të ndijojë panjohurinë thelbësore ku rrëthsillemi. Ky është burimi i vlerës estetike të përvojave të tij intuitive, i përmasës etike të *mosnjohjes* si zgjedhje artistike dhe i efektit pedagogjik të perceptimit të tij. Një paideia e *mosnjohjes* që bën edukimin e intuitës tonë pér abstrakten.

Statusi i objekteve në paradigmët estetike të *mosnjohjes* është konceptualisht i pamundur, por artistikisht i përkryer. Lëvizja konceptualizuese bllokohet sepse objektet estetike janë intuita abstrakte të kullura që shenjojnë direkt një hapësirë Idesh, pa ndërmjetësimin e koncepteve. Në këtë intensitet të përvojës estetike, të ndjesh do të thotë direkt të mendosh. Afekti bëhet njohja më imediate e Ideve më abstrakte.

Vija e drejtë ndjesi-Ide skicon një të vërtetë më të shpejtë se drita.

Sikurse trekendëshi i pamundur i Penrose mund të perceptohet por nuk mund të ndërtohet në hapësirën euklidiane tripërmasore, afekti estetik si baravyerësi topologjik i çdo objekti artistik është i papërkthyeshëm në koncept. Paska diçka krejt të hollë, ideale, prej ekzistencës, që mbërrin të kalojë nëpër filtrat e imtësishëm të përvojës estetike, por që analitika transhendendale e koncepteve nuk e ruan dot. Një zonë liminale ose më mirë, transversale, një ndërfaqe mes fenomenit dhe noumenit, ekzistencës dhe esencës, analitikes dhe sintetikes, a priorisë dhe a posteriorisë, një vijë arratje që e pret tërthorazi njësinë transhendentale të aperceptimit, Unin. Kështu, objekti i pamundur është rrjedhojë e frakturës së subjektit. Prandaj artisti i panjohur propozon vetëm sfumatura objektesh, objektitete ideale, të pamundura, *not common sensical*.

Humbja e dyfishtë e identitetit, te objekti dhe te subjekti, përruron lartësimin estetik të artistit dhe të spektatorit në dëshmitarë, si dhe drejtun askezën e tyre metafizike pér te sipërfaqja e ekzistencës.

Secili objekt i eksposuar është përzgjedhur duke i zbritur një përmasë: atë të kuptimit. Sikurse artisti ka zgjedhur ta injektojë plotësisht veten në krijim, me përjashtim të Unit të tij.

Objektet e estetizuar shenjojnë pa rrëfyer, vetëm sa shoqërojnë ildisjen e një rrëfimi të mundshëm. Elementë diagjetikë, pér një ekzegjezë që tanimë i është deleguar dëshmitarëve. Artisti ka pezulluar statusin e autorit, sikurse edhe atë të veprës. Tërë çka mbetet

nga këto dy kategorji janë një mori shenjash që bëjnë transkriptimin ose dakalkimin e ngjarjeve nga bota te një sipërfaqe ndijimi, tanimë e divorcuar nga normat e strukturës dhe ligjet e lëndës.

Artisti i mosnjohjes zbulon një mosdije themelore në thelbin e reales.

Tek kjo hapje ontologjike e vetë qenies instancohet kërkimi artistik, arkeologjia estetike e artistit. Shenjim i shenjimit, shenjë e shenjës, soditje e soditjes. Fuqi e dytë e soditjes, fuqi e dytë e shenjës. Strukturë presupozimi e ndërsjellë e planit absolut të ndijimit midis objektit të fraktalizuar dhe subjektit hemoragjik. Shenjim i shenjimit, soditje e soditjes, një elips që përjashton autorësinë e subjektit, diktaturën e faktit, hierarkinë e emrave. Hapësira abstrakte e shenjimit nuk është më metrike, por hapësirë e dialektizuar sipas një gjeometrie afine, që siguron vazhdimësinë mes të kundërtave, ku njëri skaj rrjedh pafundësisht te skaji tjetër.

Në botën e artit dialektik s'ka më kundërthenie, vetëm kundörvnie, tensionime, intensitetë.

Kur arti gjestual përuron një empirizëm transhendental, vepra e artit merr një funksion deiktik. Në gjuhë, deiktikët janë varietete semiotike të kulluara që urëzojnë ngjarjen si objektitet transhedral jogjuhësor me plazmimet e saj rrëthanore të llogaritura në gjuhë. Deiktikët janë bërësit gjenerikë të sensit, prodhuesit e së vërtetës së ngjarjeve, por s'kanë lidhje me domethënien. Domethënia është e gjitha e pacaktuar. Deiktikët janë pra fjalë apo shprehi që funksionojnë si makacione (proto)gjuhësore (këtu, tani, unë), që mundësojnë lakimin gjuhësor të ngjarjeve të botës, bash si elementë të një algjebre abstrakte që e themelon mundësinë e gjuhës. Kështu, arti deiktik është makineri abstrakte e sinestezisë, e sintezës së sensit, e prodhimit të së vërtetës. Deiksis do të thotë të bësh shenjë, të tregosh me gisht, ndërsa arti deiktik është shenjim drejt diçkaje të pakuptueshme, të padeshifrueshme, drejt mosnjohjes më të thellë, drejt vetë qenies si shenjë. S'ka mënyrë tjetër për ta menduar qenien e mendimit, pa asnje paramendim.

Afekti estetik funksionon si një deiktik sepse lidh një intensitet paradigmatik hapësirë-kohë me një sintagmë ndaj-foljore. Afekti operon një polarizim dialektik të hapësirës estetike: shqisë-mendim. Afinitet mes shqisës dhe Ideve, njohje intuitive e qenies.

Artisti i mosnjohjes mëton një lidhje direkte me Idetë si shtysa universi.

Vepra e artistit të panjohur vendoset në një sipërfaqe afine që pranëvë objektet sipas intensiteteve emocionale dhe ordinatave afektive, pavarësisht largësive kro-nometrike.

Ndihet se si një magmë viscerale, një veshtulli prej pyetjeje i përvjedh objektet e eksposuara nga perceptimi direkt dhe i lartëson në statusin e një problemi estetik. Asgjë s'i bën bashkë këto objekte minore, këto instalacione si miniaturime ontologjike, përpos habitusit shpirtëror të artistit, problemit të tij, që i vjen prej të ndjerit me tepri, prej vesisit të të paturit një virtut.

Këtu një eshtër njeriu, endoskelet, atje pak myshk, masandej dyll, copëza bimësie, atje një kandërr,

ekzoskelet, më tej një frut i tharë. Art gjeologjik, arkeologji e sipërfaqeve ndijore, arkivë e njollave, jo e fakteve. Art jokonceptual por që përbën lëndë për ushtrim të thellë intelektual, se objektet e tij rrinë Jashtë koncepteve por janë brenda ideve. Ushtrim ekocerebral: shpirti i artistit zgjedhohet brenda Ideve si abstrakte primordiale.

Artisti i panjohur është gjimnasti i së pamundurës, do të na japë atë që s'e zoteron, sensin e gjërave dhe të gjendjeve, të krijojë atë që s'e kontillon dot. Mendimi i artistit që s'di është praktikë idesh, si zgjim i lëndës te qenia e vet. Ekziston një gëzim hënor te ky artist, një gjest lunatik tekxa përzgjedh objektet për alkiminë e tij estetike. Radar intensitetesh, ludizëm fëminor, një optimizëm plastik, pa dekadencën e shpresës.

